



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1022/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit, N.T.P “Burimi Dekor” me numër të biznesit 70525720 me seli në Vushtëri, rr.“Osman e Imer Syla” p.nr, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Qerkinime & Sejdiu me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.446/2022, të datës 28.04.2023, me datë 11.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.446/2022, të datës 28.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosoës-Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.446/2022, të datës 28.04.2023, e ka refuzuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës si të pabazuar, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.4337/2020, të datës 11.11.2020, të lejuar nga zyra e Përmbartuesi Atip Mustafa, si dhe urdhërin përmbartimor P.nr.4337/20 i lejuar me datë 11.11.2020, nga Përmbartuesi privat mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, me pretendime sikurse në ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e debitorit të anulohet urdhëri përmbartimor P.nr.4337/2020 datës 11.11.2020 si dhe ta anulon aktvendimin e ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Ankesa e debitorit i është dorëzuar kreditorit dhe i njëjti e ka pranuar me datë 18.05.2023, por nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.P “Burimi Dekor” me numër të biznesit 70525720 me seli në Vushtrri me datë 10.11.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës me nr.21/18 e datës 29.06.2018 për shumën e detyrimit 3,430.00 Euro, si dhe ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Atip Mustafa duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.4337/20, të datës 11.11.2020, ka lejuar përmbartimin. Debitori në fatin ligjor ka parashtruar prapësim duke theksuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhëri përmbartimor nuk është pranuar nga debitori, ngase nuk ka prova se e njëjta mban vulën e debitorit dhe se nuk dihet as afati i pagesës apo data dhe shërbimet e kryera, rrjedhëmisht nuk kuptohet se çfarë shërbimeve ka kryer kreditori në interes të debitorit, dhe i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si e bazuar.

Përgjigje në prapësimin e debitorit nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, dhe shkresave në lëndë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.446/2022, të datës 28.04.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se fatura me nr.21/18 të datës 29.06.2018, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, është dokument i besueshëm dhe përbënë bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i ka plotësuar kushtet

ligjore nga neni 29 paragrafi 3 të LPP-së. Më tej ka arsyetuar se në faturën në fjalë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe afati për përmbushjen e detyrimit që rrjedhë nga kjo faturë, po ashtu ka shtuar se fatura është e pranuar nga debitori si dhe në shkresa të lëndës është edhe fletë-dërgesat mbi pranimin e mallrave të përshkruara si në faturë të cilat mbajnë nënshkrimin dhe vulën e pranimit të debitorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdeset dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejt faktin se fatura me nr.21/18 datës 29.06.2018, për shumën e detyrimit 3,430.00 Euro, në bazë të cilës organi përmbartues ka caktuar përmbartimin është dokument i besueshëm e kjo parashihet në nenin 29 paragrafi 1 të LPP-së, ku ceket se: përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është edhe fatura. Në rastin konkret fatura përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit konform nenit 21 si dhe nenit 29 paragrafi 3 i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar.* Andaj edhe kjo gjykatë e pranon përfundimin juridik të gjykatës se shkallës së parë sepse debitori nuk ka ofruar prova lidhur me pretendimet e tij, po ashtu në rastin konkret fatura në fjalë është e pranuar nga debitori me të cilën vërtetohet me vulën e debitorit, ku dhe e njëjta nuk është kundërshtuar nga debitori, po ashtu faturës në fjalë janë të bashkangjitur edhe fletë-dërgesa mbi pranimin e mallrave të përshkruara si në faturë të cilat mbajnë nënshkrimin dhe vulën e pranimit të debitorit, andaj kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i ankimuar i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm sepse nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet për anulimin apo shfuqizimin e urdhrit për përmbartim nga neni 71 të LPP.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II nr.1022/23, me datë 11.12.2023

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri